




| | |
|---|----------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT | |
| AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE | |
| ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. | Nr. Prot. |
| Dep. 2-D/DPK | Br. Prot. 01-3991/13 |
| Dep. | Prot No. |
| Nr. I faq. | Data |
| Broj stranica 02 | Datum 19.11.2013 |
| Nr. pages | Date |
| | PRISHTINË |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.11.2013, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-476/13, për z. *Gani Mehmetaj, Drejtor i Kosovafilm-it.- për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.*

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Pas informatës se marrë ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-476/13, që për trajtim ka pasur Zyrtarin i Lartë, z. Gani Mehmetaj, Drejtor i Kosovafilm-it .

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si, Drejtor i Kosova film-it, është duke ushtruar edhe një funksion tjetër në veprimtari private, e që sipas Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 27.04.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, z. Gani Mehmetaj, Drejtor i Kosovafilm-it, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar që ti behet një sqarim lidhur me situatën e dyshuar për konflikt të mundshëm të interesit.

Zyrtarët e Agjencisë e kanë njoftuar me faktet që posedon Agjencia, lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit, z. Gani Mehmetaj, Drejtor i Kosovafilm-it, është pajtuar me faktet, mirë po na ka njoftuar se është suspenduar nga puna dhe gjendet në procedure gjyqësore, dhe është zotuar se në moment që do të kthehet ne vendin e punës do fillojë menjëherë procedurat për ndryshimet e kërkuara nga AKK-ja.

Zyrtarët e AKK-se, kanë kërkuar nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, që të na njoftoj lidhur me statusin që ka z. Gani Mehmetaj në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS).

MKRS, është përgjigjur kërkesës tone duke dërguar vendimin e nxjerr nga Sekretari i kësaj Ministrice, ku thuhet se z. Gani Mehmetaj, Drejtor i Kosovafilm, i është shqiptuar masa e pezullimit parandalues me pagesë 50 % deri në marrje të një vendimi të ri nga organet kompetente.

Andaj konsiderojmë se zyrtari i lartë z. Gani Mehmetaj, Drejtor i Kosovafilm-it, konsiderohet që nuk është duke ushtruar funksionin e zyrtarit të lartë në këtë kohë, pasi që i njëjti është suspenduar nga puna dhe nuk ka elemente të mjaftueshme për të vazhduar me procedurë të mëtutjeshme.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

